

Dhoma Karlskrona

Gjatë viteve 1600 Suedia dhe Danimarka luftonin. Blekinge, Skåne dhe Halland u bënë provinca të reja suedeze. Suedia i humbi dy beteja të rëndësishme në det sepse flota ishte e dobët. Anija luftarake Krona (kurora) u fundos jashtë Ölandit.

Atëherë Karl XI e pa se Stokholmi nuk mjaftonte si port për marinen suedeze. Duhej një port afër pjesës jugore ku nuk kishte akull dhe ku anijet mund të lundronin në çdo kohë.

Trosö ishte ujdhesë shumë e përshtatshme ku mund të ngrirej një port i flotës që mund të mbrohej. Kjo ujdhesë ishte në pronësi të Anders Vitusit. Ai nuk donte që ta ”jipte” ujdhesën e tij, mirëpo u akuzua për plaqkitje detare dhe u fut në burg në Karlshamn. Pastaj filloi ndërtimi i Karlskronës. Thuhet se ai e kishte mallkuar Karlskronën, kështuqë sipas mallkimit ajo do të digjej, do të fundosej në ujë dhe mbi të do të binte murtaja.

Pasi që Karlskrona atë kohë nuk kishte banorë, këtu u detyruan me dhunë të shpërnguleshin banorë nga Kristianopeli dhe Ronebyja.

Disa qindra të tjerë u shpërngulën nga Stockholmi, kryesisht mjeshtër dhe ndërtues anijesh.

Këtu me dhunë ushtarake u detyruan të shpërnguleshin edhe afro 4000 finlandez.

“Jo pa gjuhën time”

Kjo fletëpalosje është realizuar në kuadër të projektit “Jo pa gjuhën time” dhe është rezultat i punës së nxënësve të shkollave fillore Wämö dhe Skrävle: Teuta e Liridona Xhemailit, Ellen Andersson, Sanna Karlsson, Casper Konradsson, Donjeta Berisha, Dennis Nilsson dhe Albin Sheqiri të udhëhequr nga: Fredrik Karlsson, Åke Franzén dhe Rizah Sheqiri.



MIRË SE VINI
NË
MUZEUN E MARINËS

Shqip - Albanska

Ekspozita, përjetime dhe aktivitete





Muzeu i Marinës

Muzeu i Marinës është ndër muzetë më të vjetër dhe më modern në Suedi.

Palma e armëve

Në hyrje është palma e armëve një vepër artistike e krijuar me rastin e vizitës që ia bëri muzeut mbreti Carl XV.

Dhoma e modeleve

Mbreti Adolf Fredrik vendosi që të ruheshin të gjitha modelet që u përdorën në kantierë të ndërtimit të anijeve.

Në atë kohë nuk përdoreshin vizatimet por modelet e detajuara në miniaturë.

Këto modele më vonë u përdorën edhe për shkollimin e detarëve.

Muzeu në fillim u quajt dhoma e modeleve.

Detaje të rëndësishme të modeluesëve janë këpucët që duken njëjtë në dy anët (në të majtë e në të djathtë) dhe shenja e fshehtë, një shirit i bardhë pëlhure në krah, që tregonte se ata që e kishin këtë shenjë ishin të besuarit e mbretit.

Në hyrje të kësaj dhome janë të varura edhe portrete të pikturuara të personave që kanë qenë përgjegjës për ndërtimin e anijeve. Është interesant se ata janë dukur sikur në pikturë.

Piktura e Amiralit me kokën e luanit tregon madhështinë dhe fuqinë e tij prej sundimtari.

Ndërsa në pikturën Anija ”Kung Carl XI” vërehen tri kurorat që janë simbol suedez, si dhe mbreti hypur në kalë, i njëjti mbret shtatorja e të cilit është e ngritur në sheshin e qytetit Karlskrona.

Përveç ekspozitave të përherëshme në muze ka edhe ekspozita të përkohëshme.



Punëtorja e anijeve

Fredrik Henric af Chapman erdhi në Karlskrona diku rreth vitit 1780. Ai ishte një mjeshtër shumë i talentuar dhe për këtë mbreti e përkrahte në mënyrë të veçantë. Me ardhjen e tij këtu, ai kishte marrë për detyrë që për dy vjet të ndërtonte disa anije luftarake, të cilat pastaj u bënë krenaria suedeze.

Jeta në anije

Edhe ekspozitat që tregojnë jetën e detarëve të thjeshtë, ushtarakëve dhe oficerëve të tyre në një anije luftarake gjatë viteve 1700 janë interesante. Anijet e tilla kanë qenë rreth 50 m të gjata dhe në bordin e tyre ka pasur rreth 600 detarë, shumë armë, municion, ushqime,etj.



Tuneli

Atë botë anijet e prishura dhe të vjetra nuk i riparonin dhe kur ato dilnin nga përdorimi i lëshionin të fundoseshin thellë në det. Kështuqë Deti Baltik është deti më i pasur në botë me mbeturina të tilla. Mbeturina të tilla anijesh gjenden në ujë edhe nën muze, ato mund të shihen nga tuneli i muzeut.

Ekspozita e zhytësve

Edhe ekspozita e zhytësve, si shumë ekspozita tjera, është mjaft interesante. Zhytësja e parë me përgatije, ora zhytëse, këpucët zhytëse, pëlumbi i zhytësve, etj janë poashtu disa nga eksponatet e muzeut që e tërheqin vëmendjen e vizitorëve të shumtë.